



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1219 Prot.

Tiranë, më 03.10 2018

VENDIM Nr. 181, datë 25.09.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.09.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Kompleks Multifunksional dhe Qendër për të moshuarit, me vendndodhje në Paskuqan, Bashkia Kamëz"-subjekti "ONI & FA" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Kompleks Multifunksional dhe Qendër për të moshuarit, me vendndodhje në Paskuqan, Bashkia Kamëz"-subjekti "ONI & FA" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Subjekti "ONI & FA" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Kompleks Multifunksional dhe Qendër për të moshuarit, me vendndodhje në Paskuqan, Bashkia Kamëz", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë  
Tel: ++355 04 45 35 855  
email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)  
Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)

5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KEMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)